

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Ganimete Hasani-Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditësit R. I., nga M., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes i Republikës së Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditësit, me datën 13 prill 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. I. nga M.
- II. ANULOHET** vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes (DNS) në Prishtinë, nr.607, i datës **29.06.2015** dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësi me padinë e datës 13 gusht 2015 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar që të anulohet vendimi i MPMS-DNS NR. 607 i datës 29.06.2015, me të cilin i është refuzuar si e pabazuar ankesa për realizimin e të drejtës në asistencë sociale. Pretendon se e paditura nuk ka bërë vërtetim të drejtë të gjendjes faktike, pasi që familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe se asnjëri nga anëtarët e familjes nuk janë të aftë për punë. Po ashtu thekson se këtë të drejtë e ka gëzuar që nga viti 2000 pikërisht për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike dhe shëndetësore. Kërkon nga gjykata që të aprovoj padinë si të bazuar, ndërsa vendimin e të paditurës ta anulojë.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 11.01.2017 e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje, nuk qëndron sepse ky vendim është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të bashkangjitura, ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës.

Në seancën e datës 13 prill 2017, palët janë ftuar me rregull, mirëpo e paditura nuk ka prezentuar, ndërsa mungesën e ka arsyetuar me parashtresën e datës 11.04.2017. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e ka mbajtur në mungesë të të paditurës.

Gjykata në seancën e datës 13 prill 2017 ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi ANJF A.nr.181/015 i datës 07.08.2015, aktvendimi nr.607 i datës 29.06.2015, raportet mjekësore ne emër te paditësit të datës 07.08.2015, 19.07.200, 05.03.2014, 06.03.2014, flete lëshimi e datës 27.01.1988,

27.12.1989, 01.11.1983, ankesa e paditësit e datës 28.05.2015, përgjigja ne padi e datës 11.01.2017, aktvendimi nr.19685 i datës 20.04.2015, vlerësimi i komisionit mjekësor i datës 07.04.2015, shqyrtimi i ankesave i datës 29.06.2015, certifikata e martesës e datës 02.03.2010, certifikata e lindjes ne emër te E. dhe R. I. të datës 02.03.2010, certifikata e vdekjes ne emër të F. I. e datës 02.03.2010, deklarata e bashkësisë familjare e datës 05.09.2013, vërtetimet nga Komuna M. të datës 02.03.2015, certifikatat nga AKK të datës 03.03.2015 si dhe aktvendimi nga QPS ne M. nr.01041 (pa datë).

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Në bazë të nenit 4 par. 4.1 të Ligjit nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, për kriteret e përfitimit të ndihmës sociale, përcakton se:

"4.1. Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njëërën prej kategorive të përcaktuara me këtë ligj".

Ndërsa paragrafi 4.4 dhe 4.5 i këtij neni përcakton se:

"4.4. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 2.7 të ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

4.5. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe :

a). me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç; apo

b). që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç".

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe duke shqyrtuar vendimin e shkallës së parë të të paditurës të datës 20.04.2015 gjykata gjen se vendimi i tillë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e LPA-së, pasi që i njëjti nuk përmban arsyetim se mbi cilën bazë paditësit i ndërpritet pagesa e ndihmës sociale. Për më tepër paditësi ka deklaruar se që nga viti 2000 ka qenë shfrytëzues i kësaj të drejte, pikërisht për shkak të gjendjes së tij të rëndë ekonomike dhe shëndetësore si i paaftë për punë, ndërsa e paditura me vendimin kontestues nuk ka sqaruar se si tani paditësit i është kthyer aftësia për punë.

Andaj, lidhur me këtë, gjykata vlerëson se e paditura vendimin kontestues e ka nxjerrë në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike, ku si pasojë është nxjerrë konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, përderisa nga shkresat e lëndës rezulton se ekzistojnë kontradikta në akte.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të nxjerrë vendim të drejtë, të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur , duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1466/15, më datë 13 prill 2017

Procesmbajtësja
Ganimete Hasani Krasniqi

G j y q t a r j a
Arjeta Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.